



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.11.2019, ora 17:00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi nw parim i projektligjeve tw Paketws Fiskale

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Arben Elezi, Anastas Angjeli, Blerina Gjylameti, Evis Kushi, Xhavit Bushaj, Antoneta Dhima, Senida Mesi, Vullnet Sinaj, Reme Lala, Artur Roshi, Krenar Ryçi, Korab Lita, Eljo Hysko

Mungojnë:

Edlira Hyseni, Ervin Bushati, Roland Xhelilaj, Ylli Shehu, Suzana Topi

Të ftuar:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Znj. Anila Denaj, Ministre

Z. Nikolla Lera, Drejtor I Pergjithshem, Drejtoria e Pergjithshme e Politikave Makroekonomike dhe Fiskale

Znj. Enkeleida Pipa, Drejtor, Drejtoria e Pergjithshme e Politikave Makroekonomike dhe Fiskale

Znj. Enkeleida Kuci, Pergjegjes Sektori, Drejtoria e Pergjithshme e Politikave Makroekonomike dhe Fiskale

Znj. Zarina Taja, Pergjegjes Sektori, Drejtoria e Pergjithshme e Politikave Makroekonomike dhe Fiskale

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj ... zoti Anastas Angjeli.

Të ftuar kemi ministren e Financave, zonjën Anila Denaj, zotin Nikolla Lera, drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave Makroekonomike dhe Fiskale, zonjën Enkelejda Pipa, drejtore në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave Makroekonomike dhe Fiskale, zonjën Enkelejda Kuçi, përgjegjëse sektori në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave Makroekonomike dhe Fiskale, zonjën Zarina Taja, përgjegjëse sektori në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave Makroekonomike dhe Fiskale.

Për sa i përket procedimit, si fillim ministrja do të prezantojë paketën një nga një dhe më pas do të diskutojë relatori. Për shkak se nuk e kemi akoma ligjin “Për fiskalizimin”

...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka ardhur akoma në Kuvend. Si fillim duhet të vij dhe në bazë të procedurës parlamentare do të futet në procedurë parlamentare, duhet ta fusim ne si komision në axhendë, që të përputhim harmonizimin e koncepteve të atij ligji me disa elemente që përmenden në ndryshimet specifike që keni sjellë në paketë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, ju lutem!

Vullnet Sinaj – Nuk i kemi marrë përgjigjet e të gjitha pyetjeve. E kishim lënë që do të na i sillnin tani në orën 17:00.

Arben Ahmetaj – Ministrja tha që do të na i sjellë me shkrim.

Në qoftë se do të kesh ndonjë merak, gjatë ditëve që do të vijnë, zoti Vullnet, mund ta ripyesni ministren nëse nuk jeni të kënaqur nga përgjigjet që do të sjellë ministrja me shkrim ose për ndonjë informacion shtesë.

Vullnet Sinaj – Nuk e kam dëgjuar kur ka thënë se do t’i sjelli me shkrim. M’u duk sikur tha se do t’i sjelli përgjigjet në orën 17:00.

Arben Ahmetaj – Jo, ministrja tha që për ato pyetje që nuk arrita të përgjigjem, dhe ne ramë dakord me ministren, do t’i sjell përgjigjet me shkrim.

Vullnet Sinaj – Dakord. Faleminderit, kryetar!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni! Po.

Anila Denaj – Ne do t’i sjellim përgjigjet me shkrim. Shpresoj të kemi edhe mirëkuptimin tuaj, sepse kemi qenë edhe në Komisionin e Ligjeve nga ora 12:00-14:00.

Megjithatë, u angazhuam që në seancën e orës 17:00 të sillnim disa përgjigje të pyetje të sesionit të paradites, siç ishte pyetja në raport me TVSH-në bruto.

Zoti Sinaj ka bërë një pyetje, e cila lidhet TVSH-në për sektorin bujqësor, të cilës unë do t'i përgjigjem në vijim, përveç përgjigjes që do ta sjell me shkrim gjatë ditëve në vijim.

Zoti kryetar a mund të vijoj me prezantimin?

Arben Ahmetaj – Po, mund vazhdoni me ligjin e parë.

Kam për të bërë një koment, zonja Ministre. Në procedurën parlamentare, për procedurën e miratimit të buxhetit Komisioni i Ekonomisë është komision përgjegjës, kështu që, ju lutem, është detyrë e komisioneve, gjithashtu, por edhe juaja, axhenda e komisioneve apo e prezencës tuaj në komisione është në funksion të këtij komisioni. Ma pas janë Komisioni i Ligjeve, Komisioni i Edukimit apo Komisioni i Veprimtarive Prodhuese.

Faleminderit!

Anila Denaj - Në raport me projektligjin e paketës fiskale 2020, sikurse e komentova edhe dje në mënyrë të përgjithshme, kjo nuk është një paketë fiskale e mirëfilltë, pasi ndryshimet kryesore konsistojnë në disa ligje fiskale që në fokus kanë miradministrimin.

Konkretisht, janë katër ligje që do të preken në këtë paketë fiskale: ligji nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat”, ligji nr. 9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, ligji nr. 9975 “Për taksat kombëtare” dhe ligji nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”.

Konkretisht, për secilin nga këto projektligje ndryshimet konsistojnë:

Për sa i takon projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28. 12. 1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, ndryshon trajtimi tatimor për tatimin e të ardhurave nga punësimi në të njëjtën mënyrë për të gjithë individët që kanë të ardhura nga paga nga më shumë se një burim. Këta individë do të kenë detyrimin për të dorëzuar deklarata individuale vjetore të ardhurash edhe nëse realizimi i të ardhurave individuale vjetore është më i vogël se 2 milionë lekë.

Së dyti, është menduar që sektori i industrisë automotive, i cili duke pasur në fokus të tij zgjerimin e punësimit dhe njëkohësisht një numër investitorësh të huaj kanë shprehur interesin për të ardhur në Shqipëri, të afrohet drejt një incentive fiskal dhe konkretisht duke caktuar normën e fitimit 5% për personat juridikë që ushtrojnë veprimtari ekonomike në këtë industri.

Elementi i tretë ka të bëjë me promovimin e sportit. Janë dy elemente në këtë paketë të sportit, të cilat kanë objektiv rritjen e impaktit pozitiv në shoqëri.

Së pari, për personat juridikë, të cilët realizojnë fitim vjetor të tatueshëm mbi 100 milionë lekë, shumat e sponsorizuara në fushën e sportit, të njohura si shpenzime të zbritshme për efekt të llogaritjes së tatimit mbi fitimin, janë të zbritshme sa trefishi i shumës së sponsorizuar. Së dyti, shpenzimet e njohura të sponsorizimit për sportin rriten nga 3 % në 5 %.

Elementi i katërt në ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat” është në raport me mbartjen e humbjes, e cila konsiderohet për një periudhë 5-vjeçare për tatimpaguesit që investojnë në këtë projektbiznes me vlerë mbi 1 miliard lekë.

Së fundi, harmonizimi i ligjit nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar” me ligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, që unë kërkoja të vijë sa më shpejtë të jetë e mundur brenda ditës së sotme pasi aprovimi është bërë ditën e djeshme me vendim të Këshillit të Ministrave.

Ligji nr. 9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” propozon ndryshime, të cilat synojnë:

harmonizimin e dispozitave përkatëse të ligjit “Për procedurat tatimore” me përcaktimet e projektligjit “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i cili sjell një risi në procesin e faturimit;

harmonizimin dhe unifikimin e kundërvajtjeve administrative. Më lejoni të theksoj edhe një herë që këto kundërvajtje administrative, sikurse e thashë edhe dje, nuk synojnë përkeqësimin e klimës së biznesit, por përshkallëzimin e masave administrative sipas tipologjisë së bizneseve për të efektuar më mirë forcën e ligjit në rastet e shkeljeve administrative.

Konkretisht, tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësi tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, të cilët nuk janë të regjistruar për TVSH-në dhe tatimpagues të tjerë dënohen me gjobë 50 mijë lekë;

tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësi tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël dhe për TVSH-në dënohen me gjobë 100 mijë lekë;

tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësi tatimore të tatimit mbi fitimin dhe për TVSH-në dënohen me gjobë 150 mijë lekë. Kjo gjë ndodh në rastin e parë të gjetjes së shkeljes. Në rastin e dytë kjo gjobë dyfishohet dhe biznesi mbyllet, por ai rihapet që në momentin e parë që kjo gjobë paguhet. Ndërsa në gjetjen e tretë qëndron i njëjti element siç është aktualisht në ligj.

Kompensimin e detyrimeve tatimore ndërmjet administratës tatimore dhe administratës doganore, sipas procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për Financat;

lidhjen e një marrëveshjeje për detyrimet që administrata tatimore ka ndaj tatimpaguesve për TVSH-në e rimbursueshme, sipas një plani pagese të rënë dakord. Ky parashikim shikohet i mundur për periudhën deri në datën 30. 6. 2021;

zgjerimin e objektit për lidhjen e marrëveshjes së pagesës me këste për detyrimet e tatimpaguesve dhe për detyrimet e vetëdeklaruarra për TVSH, si dhe për sigurimet shoqërore në raste specifike të institucioneve buxhetore;

ndryshimin e deklaratës së tatimpaguesit vetëm një herë brenda 36 muajve dhe për sigurimet shoqërore vetëm një herë në muajin pasardhës;

njoftimin e tatimpaguesit para kontrollit dhe vizitës fiskale, i cili nga 30 ditë dhe 10 ditë, do të ulet respektivisht në 10 ditë dhe 5 ditë.

Në ligjin nr. 9975 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, ndryshimet synojnë:

përjashtimin nga TVSH-ja të automjeteve të reja vetëm me motor elektrik;

harmonizimin e dispozitave përkatëse të këtij ligji me ligjin e fiskalizimit, që përmendëm pak më parë.

Në ligjin nr. 92/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9975 “Për taksat kombëtare””, ndryshimet synojnë:

saktësime të nevojshme që kanë ardhur si pasojë e zbatimit në praktikë në lidhje me aplikimin e dispozitave të taksës së makinave dhe amortizimit të makinave të luksit;

ndryshimin e përcaktimeve të vlerës të mjetit për efekt të kriterëve që duhet të përmbushë një automjet për t’u konsideruar automjet luksi. Më lejoni të theksoj, sepse ky diskutim u bë edhe dje, se automjet luksi konsiderohen autoveturat deri në 6 + 1, e cila plotëson të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

cilindratën të barabartë ose më të madhe se 3000 centimetra në kub ose vlerën, çmimin e barabartë më shumë se 5 milionë lekë. Çfarë ndryshon? Sipas këtij ligji, aplikimi i amortizimit në vlerën 10%, deri në momentin kur kjo vlerë shkon në vlerën 5 milionë lekë, është i njëjtë për të gjitha automjetet, të cilat nuk konsiderohen automjete luksi. Ndryshimi në penalitet bëhet me qëllim unifikimin e gjobës për pagesë të vonuar për taksën vjetore të mjeteve të përdorura me gjobat e aplikuara sipas ligjit “Për procedurat tatimore”, shtimin e kategorisë së personave me aftësi të kufizuar për t’u përjashtuar nga taksa vjetore e mjeteve

të përdorura; përjashtimin nga pagimi i taksës vjetore të mjeteve të përdorura (automjeteve të hershme me interes historik dhe koleksionimi), sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Fjalën e ka relatori.

Ju lutem, zoti Angjeli!

Anastas Angjeli – Unë besoj se në seancën e djeshme që zhvilluam mbajtëm një qëndrim dhe bëmë një analizë në parim. Edhe sot jemi në vazhdim të asaj seance, që, sipas kalendarit dhe procedurës, ne duhet t'i miratojmë në parim, por ne nuk do të votojmë sot, pra do të bëjmë diskutimin në parim dhe të gjitha mendimet dhe sugjerimet që kemi, që janë të lidhura me nene të caktuara, do t'i bëjmë gjatë diskutimit nen për nen, sepse kështu edhe mund të japim ndonjë kontribut për këtë paketë.

Siç e tha edhe ministrja, na janë paraqitur katër projektligje, ai për ndryshimet në ligjet: “Për procedurat tatimore”, “Për tatimin mbi të ardhurat”, “Për taksat kombëtare” dhe ai për TVSH-në. Në thelb, të katra projektligjet kanë një synim kryesor. Pa dyshim, dy projekte më shumë, dy të tjerët pak më pak, por sidoqoftë unë e thashë edhe dje, kanë synim kryesor që, në kuadër të programit dhe të përpjekjeve që qeveria bën, nëpërmjet Ministrisë së Financave dhe organeve fiskale, për uljen e informalitetit në ekonomi, për rritjen e mbledhjes së të ardhurave dhe për përshtatjen me proceset teknologjike që kanë ndodhur, na duhet që këtë legjislacion, madje më vonë edhe ndonjë ligj tjetër, ta harmonizojmë me ligjin që presim, me ligjin e fiskalitetit. Ky është thelbi i çështjes dhe, në kuadër të këtij thelbi, pa dyshim që, duke paraqitur ndryshimet në ligj, janë ndryshuar edhe disa elemente, ku më pak dhe ku më shumë, qoftë se procedurat tatimore, qoftë tek tri ligjet e tjera, që kanë të bëjnë edhe me ndonjë element që ka ardhur për rrjedhojë dhe për shkak të përvojës ose të problematikës që ka nxjerrë praktika për këto tre ligjet e sotme, duam t'i përmirësojmë sadopak.

Nisur nga ky këndvështrim, duke marrë në konsideratë se ligji ka kaluar në qeveri dhe, siç e tha edhe zoti Ahmetaj, do të ketë procedurën sa më të shpejtë nga ana e parlamentit që ne të kemi një bazë, mundet që gjatë diskutimit të atij projektligji të ndodhë edhe ndonjë ndryshim tjetër qoftë në komisionin tonë, qoftë në Komisionin e Ligjeve. Atëherë, do të jemi të detyruar që në secilin nga nenet, edhe pse tani në parim ne jemi dakord, të bëjmë ndonjë ndryshim për t'i votuar në fund para se të shkojmë në seancën plenare të datës 5, që është votimi në parim. Bie fjala, në qoftë se do të mbajmë qëndrim për kuponin tatimor ose kasat fiskale, siç është mbajtur në ligj, apo do të kemi një ripozicionim si komision për këtë çështje apo ndonjë problem tjetër.

Kështu që unë do t'i ftoj kolegët që për secilin nga projektligjet të biem dakord që të kemi të gjithë hapësirën e nevojshme që nen për nen të reflektojmë qoftë mendimet që kemi deri në këtë moment, pa e parë, pa e shqyrtuar ligjin e fiskalitetit, por, njëherazi me ndryshimet që mund t'i bëhen ligjit të fiskalitetit, kemi të drejtën që t'i reflektojmë në këto projektligje për t'ia çuar parlamentit sa më të sakta, të përputhura dhe të harmonizuara me atë ligj. Faleminderit!

Edhe diçka, në qoftë se duhen cituar sot një nga një sipas procedurës, por ne kemi rënë dakord që ta bëjmë këtë punë në datën 3, pra dy ditë para seancës, që të kemi mundësi t'i reflektojmë edhe ato, unë do t'ju ftoja që, me ndryshimet që mund të bëhen, se edhe mund të mos bëhen, në parim të jemi dakord për të katra projektligjet.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Angjeli!

Ajo që dua të...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Korab, mirë se erdhe! Kënaqësi të të kemi prezent!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani ju vuri re zoti Roshi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ajo ishte edhe ideja e zhurmës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne nuk jetojmë dot pa zhurmën tënde.

Anastas Angjeli – Si gjeneratorë ju kemi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Zonja Ministre, në referencë të prezantimit tuaj, por edhe prezantimit të zotit Angjeli, si relator, në të gjitha ligjet që keni sjellë, duke iu referuar ligjit të TVSH-së, të procedurave tatimore dhe të tri ligjeve të tjera, në këndvështrimin tim, duhet të ndalojmë me shumë kujdes nen për nen, pasi i referoheni ligjit “Për fiskalizimin”, por në të gjitha ligjet rrëzohet koncepti i kuponit tatimor. Pra, po flasim për një element tejet të rëndësishëm, të madh, gjë që do të thotë se do të prekë biznesin e vogël dhe atë të madh, si dhe procedurat.

Në studimin tim paraparak të ligjit “Për procedurat tatimore”, më duket mua, po do të më korrigjoni, keni hequr edhe konceptin e ndryshimit të deklarimit pas njoftimit të kontrollit; ndoshta jam gabim, ndoshta jo. Pra, në koncept të ligjit, tatimpaguesi ka të drejtë të

ndryshojë deklarin kur është njoftuar (kur ka marrë njoftimin për kontroll të thelluar), më korrigjoni nëse jo, sepse ashtu më duket nga leximi...

Përputhja e konceptit të faturës, si dokumenti i vetëm i lëshuar nga tatimpaguesi, besoj se do të duhet parë me shumë kujdes në vazhdimësi.

Së dyti, kasat fiskale, siç e kemi diskutuar edhe së bashku, janë një institucion që kanë vendosur disiplinë fiskale financiare, por, nisur nga leximi im i drafteve, duket sikur kasat fiskale do të bien, nuk do të ekzistojnë më, gjë që ne e kemi diskutuar edhe bashkë që nuk do të ishte një lëvizje e duhur, aq më tepër që memorja fiskale është institucion shumë i rëndësishëm brenda procedurave dhe detyrimit për deklarin.

Sot jemi duke diskutuar në parim dhe dakordësohemi në parim. Në të njëjtën formë do të dakordësohemi që nën për nën do të duhet t'i harmonizojmë të dyja korsi: edhe korsinë e ligjit bazik të fiskalizimit, edhe korsinë e ligjeve specifike, në mënyrë që të mos krijojmë konfuzion.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo na detyron që diskutimin nën për nën për paketën fiskale ta fenojmë dhe të kërkojmë futjen ose sjelljen sa më shpejt nga qeveria të draftit që ju, në dijeninë time, keni kaluar dje në qeveri, në mos gabohem. Shpresoj të kërkohe me procedurë të përshpejtuar nga qeveria, ta fusim në axhendë dhe do të detyrohemi t'i diskutojmë gati njëherazi nën për nën, në mënyrë që të jemi shumë të qartë me çfarë do të bëjmë.

Sigurisht, përtej kësaj, ne së bashku do të duhet të bëjmë edhe një diskutim politiko-teknik, përtej kamerave, për detaje, të cilat nuk mund të diskutohen, le të themi, që herën e parë në komision, pra publikisht, pasi janë elemente teknike. Pra, do të duhet të ulemi me ju dhe me stafin tuaj jashtë kamerave dhe me...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të ulemi (relatori është i pazëvendësueshëm) dhe do të vendosim se çfarë do të shkruajmë teknikisht, në mënyrë që pastaj ta ndajmë me njëri-tjetrin edhe publikisht në sy të qytetarëve dhe të medies.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, ju lutem!

Anila Denaj – Është e saktë që, në mungesë të një projektligji, nuk mund ta përfundojmë të gjithë diskutimin, pasi i gjithë harmonizimi do të kërkonte që të kalonim nën për nën.

Megjithatë, dua të përmend dy elemente shumë të rëndësishme në koncept...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sigurisht, do të duhej që t'i shikonim të dyja paketat së bashku.

Megjithatë, në koncept, edhe për faktin se procesi i fiskalizimit ka nisur që nga data 31 korrik dhe ka pasur një proces shumë të gjatë konsultimi, duke përbërë bazën e ndryshimit të diskutimit në aktet ligjore që përmendëm pak më lart, dua të përmend dy elemente që janë diskutuar me grupet e interesit dhe me publikun shpesh gjatë këtyre muajve të fundit.

Së pari, konteksti i kuponit nuk zhduket, por konteksti i mundësive për ta printuar kuponin në më shumë sesa një kasë fiskale zgjerohet dhe oportuniteti i *upgrade*-it të sistemit për të ndihmuar marrjen e të dhënave në kohë reale në administratën tatimore është vlera e shtuar.

Ndër pyetjet e bëra nga deputetët dje ishin edhe dy të tilla, ku njëra lidhej me efektin financiar që presim ne nga fiskalizimi, ndërsa tjetra kishte të bënte me konsultimin publik, por jo vetëm të kësaj, po të të gjithë paketës; më duket se pyetjen e bëri zonja Kushi.

Në raport me efektin monetar, ne mendojmë që procesi i fiskalizimit, i cili zgjat një vit e gjysmë në të tria fazat e implementimit të tij (dhe kjo do të jetë patjetër pjesë e diskutimit dhe e gjykitimit të të gjitha palëve), marrëdhënia biznes – klient, biznes – biznes dhe biznes – pagesat qeveritare synojnë optimizimin e pagesës elektronike. Pra, fokusi nuk është vetëm marrëdhënia me konsumatorin dhe gjenerimi i të dhënave në kohë reale nga më shumë se një alternativë, por është edhe zgjerimi i të gjithë marrëdhënies se si merren të dhënat në atë që është *cash* dhe *non-cash*.

Ne synojmë që në vitin 2021 të kemi një informacion të të gjitha transaksioneve që ndodhin në territorin e Shqipërisë në marrëdhënie biznesi, të diferencuara këto duke marrë edhe nga sistemi “*Business to business*, se cilat janë ato *jo-cash*, kuptohet, edhe “*Business to customer*”, se cilat janë ato *cash*. Kjo do të krijonte mundësimin e informacionit jo vetëm në kohë reale, por edhe të të gjithë dimensionit të transaksionit që ndodh.

Për të mos shkuar më tej te pjesa e produkteve, duke synuar një kategorizim produktesh të atyre që kanë edhe vëllim, edhe peshë më të madhe, sinonim edhe se si ky qarkullim të ndodhte në të gjithë zinxhirin e vlerës. Sigurisht, do ta ndihmonte analizën në administratën tatimore dhe, absolutisht, kjo nuk do të ndodhte më pa ndryshimin e sistemit se si bëhen këto analiza. Synojmë që inspektimet pastaj në biznes të jenë inteligjente dhe jo territoriale. Kjo është shumë e rëndësishme për ta thënë. Sigurisht, nuk do të ndodhë vitin që vjen, por synohet si pjesë e një procesi, i cili do të ndryshojë edhe mënyrën e menaxhimit të marrëdhënieve mes klientit dhe inspektimit, sidomos aty ku është risku më i lartë, në bazë të të dhënave më të mira.

Efektin vitin që vjen e presim në vlerën 2 miliardë lekë, kuptohet për t'u rritur në vitin 2021, që është edhe përfundimi i tij, për të arritur të ardhurat tatimore në 9,5% të produktit të brendshëm bruto.

Për sa i takon konsultimit të kësaj pakete, meqenëse ka të bëjë me shumë ndryshime ligjore dhe fiskalizimi është thelbi i tij, gjatë gjithë muajit gusht janë konsultuar të gjitha grupet e interesit, gjë që solli shumë ndryshime në nene të këtij projektligji. Unë mund të them me bindje se ka qenë i mirëpritur. Sigurisht, ka pasur edhe pasiguri, të cilat vijnë nga fakti se çfarë është ky ndryshim teknologjie, çfarë çmimi pritet të paguajë biznesi. Këto jemi të gatshëm t'i diskutojmë në vijim. Megjithatë, mund të them se ne jemi gati që të gjitha këto procese t'i efektojmë. Për t'i dhënë kohë biznesit, kemi menduar dhe kemi propozuar në ligjin që kaloi dje dy afate: për bizneset që janë të reja dhe hyjnë në marrëdhënie me administratën tatimore nga 1 janari, është menduar një kohë tremujore tranzitore, ndërsa për të gjitha bizneset aktuale për t'u adoptuar në sistemin e ri, është menduar një periudhë tranzitore gjashtëmujore, kjo, për t'u lënë të gjithë ofertuesve të shërbimit, përfshirë edhe kompanitë e kasave fiskale, kohën e mjaftueshme të kërkuar prej tyre, e cila në fillim ishte 2 muaj, pastaj u shtua në 6 muaj. Ne menduam që të kishim komoditetin e një marrëdhënieje kohe për të informuar biznesin dhe për të bërë shpërndarjen e të gjitha instrumenteve, qoftë *hardware* apo *software* nga përdoruesit në të gjithë territorin e Shqipërisë.

Megjithatë, siç e thatë edhe ju, zoti kryetar, kjo është një çështje që do të diskutohet nen për nen dhe do të kemi mundësi ta harmonizojmë dhe të diskutojmë ato pika që mund të jenë të nevojshme për t'u ndryshuar.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Dakord!

Jemi komplet të harmonizuar me logjikën e fiskalizimit në themel, por detajet janë shumë të rëndësishme, sepse bëjnë diferencë për mirë ose për shumë mirë. Pra, do të duhet që të merremi me detajet dhe ligjet janë të lidhura.

Do t'ju lutesha të tentoni edhe një harmonizim të TVSH-ja, sepse keni sjellë makinat elektrike, në mos gaboj, me zero TVSH. Makinat i përjashtoni, autobusët nuk i ngacmoni! Kjo gjë duhet të ketë edhe logjikë, ju lutem. Në qoftë se ne përjashtojmë makinat, i bie të përjashtojmë edhe autobusët, sepse gjithë logjika është tek interesi publik dhe tek transporti publik. Interesi qytetar është fundamental dhe bazik. Do të bëjmë edhe një vlerësim të kësaj politike vitin tjetër, apo do ta bëjmë që tani për autobusët elektrikë, por nuk mund të lëmë autobusët 10 dhe makinat zero. Sot unë do të bëj një amendament, po e shpall publikisht, do të propozoj kur të vijë puna nen për nen dhe sekretaria do ta depozitojë, që autobusët të jenë

të përjashtuar zero. Përderisa ju, si qeveri, keni vendosur të ikni në ekstremitet përjashtimi, në kuptimin më besnik të fjalës, ku të përjashtohen të gjitha makinat, do t'ju lutesha që kur ta sillni nen për nen, të na sillni edhe praktikën ndërkombëtare, sepse në dijeninë time modeste për këtë punë, në përgjithësi makinat ose marrin kupon mbrapsht, ose kanë TVSH të reduktuar. Megjithatë, qeveria ka menduar që të ecë në ekstremitet përjashtimi. Dakord, ne jemi në harmoni të plotë me logjikën e qeverisë, por do të duhet të harmonizojmë instrumentet. TVSH-ja e makinave të përjashtuar, TVSH-ja e autobusëve për transportin publik të jetë e përjashtuar, pra të harmonizojmë politikën se pastaj i bie të krijojmë kundërkohë në politikën fiskale.

Përfundimisht, në qoftë se dikush ka ndonjë koment ose pyetje, jeni të mirëpritur.

Kini parasysh të gjithë deputetët, që për shkak të lidhjes me një draftligj që ende nuk ka ardhur në Kuvend, të referimit gati nen për nen të atij draftligji, unë do të sugjeroja, por kjo është në lirinë tuaj, që t'i lëmë debatet dhe diskutimet kur të vijmë nen për nen. Nëse keni ndonjë koment të përgjithshëm jeni të mirëpritur.

Faleminderit!

Artur Roshi - Në mbështetje të logjikës së kryetarit të komisionit, zonja Ministre, do të mbështesja faktin se ne nuk kemi vetëm makinat elektrike këtu që nuk e ndotin ambientin, por janë edhe tipet e fundit hibride...

Drejtor, në të gjithë botën ato subvencionohen, nuk po themi përjashtohen tërësisht makinat hibride pse janë sipas parametrave të fundit, kështu që, në qoftë se ne themi që kujdesemi për mjedisin, logjika duhet të shkojë në të gjitha. Nuk ka rëndësi 100 %, sepse ajo punon me benzinë dhe me bateri, pra është hibride, por mund të shkarkohet TVSH-ja në 10 apo 5 % në logjikën e asaj që tha kryetari për autobusët dhe të gjitha kategoritë e makinave. Mendoj se duhet ta shohim për ta përfshirë.

Do të kisha dëshirë që në amendamentin që do të bëjë kryetari, të jetë e përfshirë edhe kjo që them unë.

Arben Ahmetaj – Do ta diskutojmë nen për nen, të marrim edhe mendimin dhe reflektimin e Ministrisë së Financave për atë që propozoi.

Artur Roshi - Logjika është të diferencohet nga ato që ndotin ambientin!

Arben Ahmetaj – Në respekt të propozimit tuaj do ta diskutojmë nen për nen dhe do të gjykojmë.

Po, zonja Senida.

Artur Roshi - Nuk kam mbaruar!

Zonja Ministre, më pëlqen pjesa inovative, përshtatja me to dhe sistemi fiskal, sepse bëhet shumë komod, por pyetja ime është: a u vlen të gjitha niveleve apo grupeve të biznesit ky komoditet?

Arben Ahmetaj – Cilit ligj po i referoheni, zoti Roshi?

Artur Roshi - Ligjit të faturës fiskale.

Arben Ahmetaj – Nuk ka ardhur ende, nuk kemi asgjë.

Artur Roshi - Unë po flas në parim se çfarë përfiton qytetari nga kjo...

Arben Ahmetaj – Po, por nga ana procedurale, ndjesë, por nuk ka ardhur akoma dhe ne nuk e dimë.

Artur Roshi - Dy fjali janë këto.

Sa herë që bëhet një projektligj, ju shikoni se çfarë përfiton buxheti, administrata dhe qeveria. Unë jam i prirur të shikoj se çfarë fiton qytetari, sepse, që të bësh një investim, edhe qeveria për atë e bën, që të lehtësojë dhe të ketë përfitime ekonomike qytetari. Gjithë pikëpyetja, sipas meje, është se çfarë përfiton qytetari nga futja e kësaj risie të shprehur në këtë projektligj. Kjo është ajo që më shqetëson mua.

Kryetar, kam një propozim për sekretarinë e komisionit. Ato po punojnë jashtë orarit, pasi e provova vetë dje, pas orarit zyrtar, dërgova pyetjet dhe më bëri përshtypje që ishin ende në ambientet e zyrave. Nëse do të jetë e mundur, të propozojmë që t'u jepet një shpërblim në fund të vitit punonjësve të administratës që punojnë jashtë orarit zyrtar.

Arben Ahmetaj – Do t'ia propozojmë Kryetarit të Kuvendit, patjetër!

Faleminderit!

Po, zonja Senida.

Senida Mesi – Përshëndetje!

Duke falënderuar ministrinë dhe ministren për propozimet për ndryshimet e pagesës fiskale, duke dëgjuar edhe diskutimet në lidhje me amendimet nen për nen të kësaj pakete, shqetësimi im ka të bëjë me një fakt shumë të rëndësishëm, mos po shkatërrojmë metodikën, sepse po vihen disa taksa apo reduktime TVSH-je? Kemi dy propozime: përjashtim të TVSH-së për makinat elektrike, nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, mosimplementim ose mosvënje të taksës për qarkullimin e dy kategorive të makinave të përdorura, makina historike apo makina të blera të përdorura nga personat me aftësi të kufizuara.

E para, kur bëjmë një amendim apo vendosje taksash, logjika jonë duhet të shkojë në të njëjtën linjë. Duam të vendosim taksa dhe të bëjmë përjashtime nga TVSH-ja, sepse duam të mbrojmë mjedisin, dhe, nëse është kështu, ato dy taksa, taksa e qarkullimit dhe TVSH-ja, a janë në kundërshtim me njëra-tjetrën?

E dyta, kemi marrë përsipër direktivat e BE-së, përfshi këtu edhe politikën fiskale në lidhje me mbrojtjen e mjedisit.

E treta, që është shumë e rëndësishme, nëse duam të përjashtojmë nga TVSH-ja një makinë jo luksi ndoshta, të dikujt që ka kapacitetin dhe buxhetin për ta blerë, pavarësisht TVSH-së, a është më mirë që ne të diskutojmë për reduktimin e TVSH-së për produktet bazë të paketës bazë ushqimore duke filluar nga buka, qumështi, veza, të cilat automatikisht dhe në mënyrë direkte bëjnë që një klasë e caktuar e shoqërisë të përfitojë në xhep atë çfarë duhet në fund të muajit dhe jo të bëjmë diferencim një kategori qytetarësh, që kanë mundësi ta blejnë makinën hibride, të cilët nuk e kanë problem nëse do të paguajnë 10 apo 15 % më shumë TVSH?

Pra, këto duhet të ishin në bazë dhe në themel të diskutimeve që do të duhej të ndërmerrnim në këtë komision.

Ju faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Mesi!

Zonja Ministre, do të donit fjalën?

(Diskutim pa mikrofon)

Mirë është që t'i përmbledhësh.

Ajo që tha zonja Mesi, për makinat antike, nëse ligji do të arrinte të bënte atë dhe ne të binim dakord, do një harmonizim edhe në logjikën fiskale, në njërën anë bën një gjë, në anën tjetër bën një gjë tjetër, duhet të jenë të peshuara të dyja brenda spektrit, por do një definicion shumë të saktë të makinave antike. Koleksionistët mund të kenë regjim të përkohshëm, ndërkohë, ata që koleksionojnë, presupozohet që makina që koleksionohet, në politikën dhe teorinë fiskale ka gati-gati konceptin e mallit të akcizës dhe të luksit...

(Diskutim pa mikrofon)

Po e ndaj me ministren edhe këtë merak që kemi.

Pra, gati-gati kthehen në mallra të akcizueshme, që do të thotë se ai është mall luksi dhe ai që e koleksionon është një njeri që bën pjesë te 1-2% i popullsisë. Praktikisht ne po përjashtojmë nga TVSH-ja këtë grup tatimpaguesish. Në këndvështrimin tim personal, si përfaqësues i maxhorancës së majtë, ku lehtësojmë dhe balancojmë shtresat në nevojë me taksim të ndershëm në spektrin e mësipërm, besoj se duhet ta rishikojmë këtë logjikë së bashku, ku makinat e luksit që kthehen në antike dhe koleksionohen, të trajtohen me dinjitet fiskal të ngarkuar gati si mallra të akcizueshëm.

Megjithatë, nen për nen do të kemi mundësi të debatojmë me shumë kujdes për balancat fiskale që krijojmë, se dikush brenda nesh, po marr veten si shembull, vij të

përrjashtoj makinat bujqësore, pastaj edhe makinat antike të vlefshme. Gjithsesi këto do të vijnë si elemente nën për ne. Besoj se relatori do të futet në detaje dhe do ta orientojë komisionin.

Është shumë e rëndësishme kostoja e fiskalizimit për tatimpaguesin, në këndvështrimin tim. Njohja paraprake me draftligjin, midis të tjerash ka dy kosto, atë të certifikimit dhe koston e mirëmbajtjes. Së bashku me komisionin do të bëjmë një dëgjese të detajuar me shoqatat e biznesit.

Kam një pyetje që do ta sqarojmë në diskutimin nën për nën. Cila ka kosto më shumë, të mirëmbash një soft, apo të mirëmbash një kasë? Në varësi të kësaj, së bashku do të vendosim si do të ecim me kostot, me atë të certifikimit, të mirëmbajtjes së softit, të faturës apo të kuptonit, do ta hartojmë nën për nën dhe do ta përputhim edhe me draftet e tjera që keni sjellë.

Zonja Dhima, kishte diçka për të shtuar.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Ministre, për shpjegimet, sugjerimet dhe përgjigjet e të gjitha pyetjeve që kemi bërë ne si deputetë!

Faktikisht, dua të ndaj me ju një shqetësim për një problem social.

Në tabelën nr. 3 të transfertës së pakushtëzuar të bashkive për vitin 2020 janë planifikuar fonde për bashkitë sipas formulës për transfertën e pakushtëzuar, si edhe fonde për funksione, të cilat u janë transferuar bashkive pas zbatimit të reformës administrative-territoriale.

Së pari, gjej rastin t'ju falenderoj që pas 3 vjetëve financohet nga ana juaj në zërin “administrimi i pyjeve”. Në zërin “mbrojtja sociale”, duke parë tabelën, vihet re që janë financuar vetëm gjashtë bashki, çka do të thotë që ka shumë bashki të tjera, të cilat kanë qendra ditore të personave me aftësi të kufizuara dhe nuk janë financuar nga ana juaj. Sipas informacionit që unë kam, në Bashkinë e Fierit ushtron veprimtarinë e saj qendra “Horizont”, ku trajtohen gati 90 fëmijë me aftësi të kufizuara, të cilët vijnë nga tre bashkitë e qarkut, Fier, Patos dhe Roskovec. Deri në datën 26. 10. 2016 kjo qendër është financuar nga një projekt italian dhe nga data 26. 10 ...

Arben Ahmetaj – Më fal!

Zonja Dhima, në të drejtën tuaj, unë e njoh çështjen. Besoj se e keni fjalën për qendrën “Horizont”, e cila ka gati 90 fëmijë në rrethin e Fierit dhe që po i mbaron financimi nga donatorët ...

Antoneta Dhima – I ka mbaruar financimi dhe ka pothuajse ...

Arben Ahmetaj – E qartë. Ne do të kujdesemi si komision që ajo qendër të mos ngelet pa financim. Është edhe detyra jonë. Do ta rakordojmë me ministren.

Zonja Ministre, nuk keni nevojë të përgjigjeni sot për këtë çështje, sepse kur të diskutojmë nën për nën shpenzimet, por edhe shpenzimet e pushtetit vendor, do të diskutojmë edhe këtë çështje.

Faleminderit!

Fjalën e ka ministrja dhe relatori për ta mbyllur.

Antoneta Dhima – Shumë faleminderit, zoti kryetar!

Unë mora shkas nga ajo që ju si kryetar i komisionit thatë që duhet të kemi projekte për mbështetjen sociale. Njëkohësisht, qeveria e ka pasur dhe e ka në vëmendjen e saj, kështu që patjetër që ministrja do të na mbështesë në këtë projekt.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Ministre, ju lutem!

Anila Denaj – Faleminderit!

Në raport me pyetjen dhe shqetësimin që ngriti deputeti Roshi se çfarë është risia për biznesin, pse duhet të hyrë në këtë proces dhe njëkohësisht elemente që lidhen me koston, nuk dua të shkoj në detaje, sepse sigurisht ne do t'i trajtojmë këto kur të vijë projektligji dhe t'i trajtojmë nën për nën, por ajo që shikoj shpesh në komente është që akoma nuk është kuptuar që ky projektligj nuk krijon ngërçe, por oportunitete. Një nga oportunitetet për biznesin është një mundësi më shumë sesa ajo e sotmja në përdorim të pajisjeve. Nëse sot kemi një kompjuter dhe një pajisje fiskale që quhet kasë fiskale, nesër mund të përdoret e njëjta, sikurse mund të përdorë vetëm kompjuterin ose mund të përdorë vetëm këtë. Biznesi që është duke kryer udhëtim në Valbonë të mos paguajë deftesë tatimore, shpresoj, por me një lutur printer të ketë mundësi ta lëshojë zërin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të gjitha bizneset sot janë në një ritëm të caktuar të lidhjes me raportimin, i cili sot është në marrëdhënie me administratën tatimore. Kjo nuk do të ndryshojë limitet, përkundrazi do të japë oportunitete për të përdorur më shumë sesa një pajisje. Kjo pajisje do të ketë të mundur edhe një aplikacion, i cili sigurisht do të ketë koston e mirëmbajtjes.

Ndërkohë, për sa i takon elementit të harmonizimit të paketës, unë e thashë që në fillim të herës që kjo nuk është një paketë e mirëfilltë fiskale, sepse, edhe me ndihmën e FMN-së, ne jemi duke bërë një analizë të të gjitha masave, me qëllim që vitin tjetër, edhe për

të synuar një paketë fiskale 3-4 vjeçare (kjo është edhe direktivë e BE-së), të kemi mundësi të harmonizojmë të gjitha raportet.

Megjithatë, më lejoni të them që reduktimi i TVSH-së për makinat e luksit nuk mund të shikohet në kundërshti me atë që ka të bëjë me mjetet, të cilat për personat me aftësi të kufizuara mendohet si një lehtësi. Nuk ka barazi. Nëse duam që lehtësitë për personat e tjerë të jenë edhe për personat me aftësi të kufizuara, kjo është një lehtësi për personat me aftësi të kufizuara. Ndërsa për sa u takon mjeteve elektrike, autobusëve, jam dakord që harmonizimi aty mund të diskutohet për të pasur të njëjtën gjuhë. Kjo mund të jetë si në kahun zero, ashtu edhe në kahun aktual të autobusëve. Është pjesë e diskutimit. Gjykuam që automjetet kanë një qasje në numër më të lartë dhe nxitja e individëve për të blerë këto automjete me një stimul më të lartë sesa të tjerat, do të krijonte një mundësi që këto automjete të hynin në Shqipëri nga vetë qytetarët. Kjo është diferenca që është bërë në krahasim me autobusët.

Ndërkohë, për sa i përket taksës së automjeteve, të cilat konsiderohen me efekt historik, në dijeninë time janë shumë pak. Nëse nuk gaboj janë 300. Më shumë sesa konteksti se cilës shtrese ekonomike i takon, lidhet me faktin që këto mjete nuk janë në qarkullim. Megjithatë, kjo është pjesë e diskutimit që ne mund ta bëjmë dhe në bazë të kërkesës suaj për mendim, ta diskutojmë.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Ministre!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, zoti Roshi, se do ta mbyllim!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Roshi, do ta diskutojmë nen për nen. Ju keni të drejtën procedurale ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mbani qetësi, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Roshi, miqësisht ju tërheq vëmendjen që ta dëgjojmë njëri-tjetrin.

Pra, kur të shkojmë nen për nen, do ta diskutojmë edhe konceptin e makinave antike, që janë mjete luksi pavarësisht nëse janë në qarkullim apo jo. Nëse vjen puna për të diskutuar qarkullimin, i bie që ... Nuk do t'i hyjmë asaj, por do ta diskutojmë nen për nen.

Ne e kemi dakordësinë me ministrinë dhe ministren që t'i diskutojmë me qetësi një nga një për të arritur rezultatin e duhur.

Fjalën e ka relatori për të bërë mbylljen e mbledhjes.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal!

Zoti Vullnet, kur të vijë, ju do të bëni asnjë pyetje më pak se dhjetë.

Faleminderit!

Po, zoti Angjeli.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kur të të vijë radha.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Vullnet, respekt për relatorin.

Anastas Angjeli – Falenderoj ministren dhe të gjithë kolegët!

Së pari, pavarësisht se u përpoqëm të mbeteshim në parim, nuk mund të shmangeshim, sepse disa gjëra që janë në parim janë edhe të detajuara në nene. Thelbi i çështjes mbetet që ne duhet të jemi shumë të vëmendshëm për të harmonizuar të gjitha problemet që u ngritën në funksion të ligjit të fiskalitetit.

Së dyti, meqenëse u fol shumë për çështjen e taksave të automjeteve, nuk duhet parë thjesht në këndvështrimin e kategorive që favorizohen ose jo nëpërmjet diferencimit që i bëhet në taksë, por duhet parë në kuadër edhe të politikave që ngritëm dje, sot dhe që Senida i përmendi përsëri. Kur flasim për makina elektrike, nuk flasim për t'u bërë favor dy vetave, por flasim për një vizion, për të ardhmen, që jemi duke u larguar nga automjete, të cilat ndotin ambientin dhe po shkojmë drejt automjeteve që mbajnë një ambient më të pastër. Nëse në një moment të caktuar i duhet vendit (ne nuk po vendosim tani, sepse kryetari tha që do ta shikojmë nen për nen), do të marrim edhe efektet financiare nga numri i makinave dhe autobusëve që janë, si dhe numri i veteranëve të mundshëm, që kanë statusin veteran, që mund të ngasin makina të tilla. Çështja këtu është se po flasim për një vizion. Nëse dje dhe sot folëm për një vizion dhe i kërkojmë qeverisë dhe ministres me insistim, është shumë mirë po fillojmë të mendojmë për këtë të ardhme, për elektronikën dhe përdorimin e saj. Gjithashtu, duhet të mendojmë si të shkojë interneti, për shembull, në majë të fshatrave të Gramshit në mënyrë që të kenë mundësi ta përdorim edhe ata. E rëndësishme është që vizioni ynë është i orientuar drejt qëllimit, teknologjisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të shkojnë të dyja paralelisht.

Pra, vizioni ynë është i orientuar drejt përmirësimit të ambientit, por gjithmonë duke pasur balancat, sepse po nuk patëm balancat, nuk realizojmë dot asgjë.

Unë mendoj që diskutimi i sotëm i hapi rrugën pozitivisht reflektimit të mendimeve që u shfaqën mbi bazën e ligjit që do të diskutojmë të parin dhe mbi bazën e një konsulte me komunitetin e biznesit, që propozoi kryetari.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Ministre dhe grupit tuaj të punës!

Zoti Lera, dua të më sillni zyrtarisht TVSH-në bruto.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Na e sillni nesër meqë nuk e sollët sot.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E duam zyrtarisht të saktë, fatkeqësisht në referencë të shifrave.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka gjë, sille nesër.

Pas seancës së ditës së nesërme për një rezolutë specifike, që fillon në orën 10:00, ju lutem, zonja Ministre, harmonizoni axhendën, sepse do të mblihdemi menjëherë këtu. Do t'ju lutesha që të përgatiteshit edhe në axhendë me qëllim që të vazhdojmë axhendën e diskutimit të buxhetit.

Të nderuar anëtarë të komisionit,

E nderuar zonja Ministre,

Sapo të mbarojmë seancën do të vijmë menjëherë këtu.

Faleminderit të gjithëve!

Kalofshi mirë!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti